

19-4



Nr. Prot. 710
Datë 18/04/2012

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SE KONSUMATORIT
MINISTRI

Prot 17410

URDHËR

Nr. 125 Date 18. 4 2012

“PËR DISA MASA MBI KOORDINIMIN E KONTROLLEVE NË LIDHJE ME
PROÇESIN E THERJES SË KAFSHËVE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 47, pika 3, germa (ç), të Ligjit Nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, me propozim të Drejtorisë së Sigurisë Ushqimore dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit,

URDHËROJ

1. Për çdo ngarkesë me kafshë e cila hyn në Pikat e Inspektimit Kufitar, Drejtoria e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), njofton menjëherë Drejtorinë e Shërbimit Veterinar pranë Ministrisë.
2. Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministri njofton menjëherë Sektorin e Veterinar në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë e cila është kompetente për qarkun drejt së cilës ngarkesa me kafshë ka destinacionin.
3. Sektori Veterinar në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë dhe Drejtoria Rajonale e AKU-së në qarkun përkatës, me marrjen e njoftimit verifikojnë mbajtjen e ngarkesës së kafshëve në destinacion si dhe procesin e mbajtjes së kafshëve në karantine ose therjen e tyre brenda 72 orësh, në vartësi të përcaktimeve të çertifikatës veterinarë që shoqëron ngarkesën.
4. Në rast se, pas verifikimit të bërë, vërtetohet se subjekti importues nuk i ka mbajtur kafshët në karantinë dhe nuk ka kryer therjen e kafshëve me therje të menjëhershme brenda 72 orëve, Sektori Veterinar në Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë vepron si me poshte;
 - a vendos në karantinë kafshët të cilat nuk janë therur brenda 72 orëve;
 - b verifikon therjen e kafshëve pas përfundimit të karantinës;
 - c propozon në Drejtorinë e Shërbimit Veterinar, masën në lidhje me pezullimin ose revokimin e liçencës së subjektit në mbështetje të legjislacionit përkatës.
5. Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministri njofton Drejtorinë e Përgjithëshme të AKU-së për vendimin e marrë në lidhje me subjektin.

6. Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së njofton Pikat e Inspektimit Kufitar për:

- a. subjektet të cilat kane realizuar therjen e kafshëve brenda 72 orëve;
- b. subjektet ndaj të cilave është marre masa e pezullimit ose e revokimit të licencës.

7. Pikat e Inspektimit Kufitar me marrjen e njoftimit, nuk lejojnë subjektet sipas pikes 6, gërma (b), të kryejn aktivitetin e tregtimit të kafshëve të gjalla.

8. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Veterinar, Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

